Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/806
Datë: 27.12.2023

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 21.12.2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet** akreditimi dhe validimi i institucionit "OSKAR KAMMER SCHULE MBH-FT SH.P.K" me adresë: rr. "Vëllëzrit Fazliu" Prishtinë Republika e Kosovës, me kualifikimet:

   1.1. **ASISTENT I KUJDESIT SOCIAL SHËNDETËSOR**, Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji i kualifikimit: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 180 kredi të AAP.

   1.2. **BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL I INFERMIERISË**, Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji i kualifikimit: Kualifikim Kombëtar (D) me 180 kredi të AAP.

A r s y e t i m

Institucioni "OSKAR KAMMER SCHULE MBH-FT SH.P.K" me datë 13.02.2023 ka parashtruar në AKK kërkesën për akreditim dhe validim të institucionit me kualifikimet: Asistent i Kujdesit Social Shëndetësor dhe Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë niveli III dhe IV sipas KKK, e cila është protokolluar dhe ka marrë numër 01/56. AKK ka shqyrtuar dosjen e aplikimit të institucionit dhe pasi aplikacioni i ka plotësuar kushtet e parapara sipas dispozitave ligjore në fuqi e njëjta është aprovuar nga ana e Këshillit Drejtues të AKK-së dhe është vazhduar tutje me procedurat tjera të procesit. AKK nga lista e eksperteve të aprovuar nga Këshilli Drejtues ka zgjedhur ekipin vlerësues për këtë institucion, i cili me datë 10.08.2023 ka shqyrtuar dosjen e aplikimit të institucionit "OSKAR KAMMER SCHULE MBH-FT SH.P.K". Ekipi i eksperteve me datë 14.08.2023 ka realizuar vizitën në këtë institucion, ndërsa pas rekomandimeve të dhëna nga institucioni me datë 12.10.2023 ekipi vlerësues ka shqyrtuar përsëri dokumentacionin.

Ekipi vlerësues i eksperteve me datë 19.10.2023 ka realizuar vizitën e dytë në këtë institucion, ndërsa me datë 24.10.2023 ka përpiluar raportin vlerësues përfundimtar për akreditim dhe validim të institucionit. Këshilli Drejtues i AKK-së me datë 30.11.2023 ka mbajtur mbledhjen e VII të tij për këtë vit, ku pikë e rendit të ditës ka qenë edhe shqyrtimi i raporteve të ekipit të eksperteve për institucionin "OSKAR KAMMER SCHULE MBH-FT SH.P.K".

Këshilli pas diskutimeve të shumta si dhe vërejtjeve e paqartësive që kishte në raportet e përpiluara me shumicë votash vendosi që për mbledhjen e VIII të KD-së t'i ftoj ekspertet e jashtëm të cilët kanë hartuar këto raporte për të dhënë sqarime shtesë rreth përmbajtjeve të raporteve sa i përket plotësimit të kushteve dhe kritereve nga ana e institucionit.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve me datë 21.12.2023 ka mbajtur mbledhjen e VIII të Këshillit Drejtues dhe pikë e rendit të ditës për trajtim ka qenë edhe shqyrtim i raporteve të ekipit të eksperteve për institucionin "OSKAR KAMMER SCHULE MBH-FT SH.P.K". Në takim me ftesë të Këshillit Drejtues kanë marrë pjesë edhe ekspertet për të ofruar sqarime shtesë rreth paqartësive dhe pyetjeve që kishte Këshilli Drejtues.

Pyetja drejtuar ekspertëve ka qenë: a ka ofruar institucioni dëshmi me të cilën faktohet qëndrueshmëria financiare e tij? Sepse në raportin vlerësues, tek plotësimi i kritereve sa i përket strukturës së nevojshme institucionale dhe qëndrueshmërisë financiare thuhet se ky kriter plotësohet kryesisht. Ndërsa siç është cekur edhe në raportin përfundimtar të përpiluar nga ekipi i ekspertëve, të njëjtit edhe gjatë takimit kanë theksuar se shkolla Oskar Kammer Schule ka planifikim të mbështetjes financiare nga shkolla Oskar Kammer Schule në Gjermani, mirëpo nuk ka prezantuar ndonjë dokument që ka dëshmuar se garanton alokimin e mjeteve financiare. Po ashtu institucionit i kanë rekomanduar të dëshmohet mbështetja financiare e shkollës nga Oskar Kammer Schule në Gjermani, megjithatë edhe gjatë takimit nuk u prezantua ndonjë dëshmi me të cilën vërtetohet qartë mbështetja financiare për institucionin.

Këshilli kërkoj sqarime nga ekspertet edhe sa i përket plotësimit të kritereve për pikën e gjashtë (6) nga raporti vlerësues që ka të bëjë me politikat dhe procedurat për vlerësimin e kandidatëve me aftësi të kufizuara ku në raportin vlerësues për akreditim të institucionit ekipi vlerësues i ekspertëve ka theksuar se kjo pikë plotësohet pjesërisht, dhe tek komentet është cekur se objekti nuk përmbush kushtet për çasje për nxënësit me aftësi të kufizuara, sepse shkolla Oskar Kammer Schule ka planifikuar që të shfrytëzoj hapësirën e katit të dytë të objektit, derisa nuk ka as ashensor dhe as pjerrina për mundësi të lëvizjes së personave me aftësi të kufizuara. Pas kërkesës nga Këshilli Drejtues, ekspertet kanë ofruar sqarime shtesë duke theksuar se objekti nuk përmbush kushtet për çasje për nxënësit me aftësi të kufizuara, nuk ka ashensor e as pjerrina për qasjen e nxënësve dhe personave me aftësi të kufizuara, si dhe theksuan faktin se shkolla ka planifikuar që mësimin ta mbaj në katin e dytë të objektit.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së pas analizimit në detaje të raporteve vlerësuese të eksperteve, përgjigjeve të dhëna nga ekspertët e jashtëm në pyetjet e parashtruara nga anëtaret e Këshillit Drejtues me shumicë votash vendosi të refuzohet akreditimi dhe validimi i Institucionit "OSKAR KAMMER SCHULE MBH-FT SH.P.K" me kualifikimet e cekura si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij vendimi i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:
1. Institucionit "OSKAR KAMMER SCHULE MBH-FT SH.P.K"
2. Arkivit të AKK-së

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së